

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7894  
E shtunë, 28 shtator 2024  
Çmimi 0.50 €

“Gallup”: Kosova, ndër vendet më të sigurta në botë | **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ‘GAP’-i: VETËM 42 PËR QIND TË PREMTIMEVE JANË REALIZUAR NGA KRYETARËT E KOMUNAVE



Instituti GAP ka publikuar të premtën shkallën e përbushjes së premtimeve zgjedhore të dhëna nga kryetarët e komunave për

mandatin 2021-2025. Ky përditësim përfshin periudhën deri në fund të qershorit 2024. Nga gjithsej 1 816 premtime të dhëna nga 27 kryetarë të

komunave, 765 premtime apo 42 % janë përbushur plotësisht, ndërkaj 304 premtime apo 17 % konsiderohen gjysmë të përbushura



**‘NGECËN’ LIGJI PËR SINJALIZIMIN E KORRUPSIONIT, KDI-ja INKURAJON QYTETARËT TË KONTRIBUOJNË PËR TË MIRËN E PËRGJITHSHME** **F.3**



**OSMANI NË PRITJEN E PRESIDENTIT AMERIKAN: ALEANCË QË QËNDRON NË THEMELET E SHTETIT TONË** **F.3**

### OPINION

**ROLI I DIPLOMACISË SË SHOIPËRISË NË FORUMET NDËRKOMBËTARE DHE ANGAZHIMI PËR PRANIMIN E KOSOVËS NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE** **F.7**

Shkruan:  
Prof. Dr. Fejzulla  
BERISHA



### AKTUALE



**BESNIK TAHIRI: ADMINISTRATA SHTETËRORE NË BLOKADË!** **F.3**

**KONSTITUOHET MENAXHMENTI I RI I UP-së** **F.6**

**RRITJE E NDJESHME E RASTEVE ME KANCER** **F.7**

### EKONOMI

**ME “DYFISH MË SHTRENTJË”, KOSOVA TRUMBETON INFLACION TË ULËT** **F.8**

**KOSOVA PËRMBYLL ME SUKSES MARRËVESHJEN E TREGTISË SË LIRË ME VENDET E EFTA-s** **F.8**

### SPORT



**LLAPI NJOFTON ME HUMBJE SUHAREKËN, SOT ZHVILLOHEN DY NDESHJE** **F.10**

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçishtë - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Nëndetësja e re bërthamore e Kinës fundoset gjatë ndërtimit, thotë një zyrtar amerikan

WUHAN, 27 SHTATOR - Pamjet satelitore kanë treguar se nëndetësja më e re bërthamore sulmuese e Kinës është fundosur gjatë ndërtimit, tha të enjten një zyrtar amerikan i Mbrojtjes.

Për Kinën, fundosja e nëndetësës së parë të klasës Zhou paraqet dështim, pasi Pekini është duke bërë përpjekje ta ndërtojë marinën më të madhe në botë. Pekini ka shfaqur vetëbesim të madh në pretendimet e tij për ta pasur në kontrollin e vet tërë Detin e Kinës Jugore, i cili është kyç për tregtinë ndërkombëtare. Ndërkohë, Kina përballlet me



mosmarrëveshje të kamotshme territoriale me vende të tjera në rajon, duke përfshirë Brunein, Malajzinë, Filipinet, Tajvanin dhe

Vietnamin. Shtetet e Bashkuara synojnë t'i forcojnë lidhjet me aleatët e tyre në rajon dhe lundrojnë

rregullisht në ato ujëra në operacione që ata thonë se ruajnë lirinë e lundrimit për anijet atje, duke e zemëruar kështu Pekinin.

Kjo nëndetëse me gjasë u fundos mes muajve maj dhe qershor, kur pamjet satelitore shfaqen vinça të cilët do të ishin të nevojshëm për ta nxjerrë atë nga fundi i lumit, tha zyrtari amerikan, i cili foli në kushte anonimiteti.

Kina është duke e ndërtuar flotën e vet detare me shpejtësi të madhe. ShBA-ja e vlerëson ngritjen e Kinës si shqetësimin më të madh për sigurinë e saj në

të ardhmen.

Ambasada kineze në Uashington tha të enjten se nuk ishte "në dijeni me situatën" dhe se nuk ka informata për të ofruar.

Zyrtari amerikan tha se nuk ishte "befasi" që marina kineze do ta mbajë të fshehtë këtë dështim.

Lajmi për fundosjen e nëndetësës vjen në një javë kur Kina e lëshoi si rrallëherë një raketë balistike ndërkontinentale në ujërat ndërkombëtare në Oqeanin Paqësor.

Ekspertët thonë se ky ishte testi i parë që Pekini e ka kryer prej vitit 1980.

## Netanyahu thotë se Izraeli do t'i vazhdojë bisedimet për armëpushim në Liban

JERUSALEM, 27 SHTATOR - Izraeli do të vazhdojë t'i diskutojë propozimet për armëpushim në Liban në ditët në vijim, tha të premten kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu.

Shtetet e Bashkuara kanë paralajmëruar se përshkallëzimi i konfliktit në mes të Izraelit dhe Hezbollahut do ta bëjë edhe më të vështirë kthimin e civilëve në shtëpitë e tyre në të dyja anët e kufirit.

Hezbollahu është grup militant dhe parti politike njëkohësisht, i cili e kontrollon pjesën më të madhe të Libanit jugor.

Ministri i Jashtëm i Izraelit, Israel Katz, i hodhi poshtë të enjten thirrjet e ndërkombëtarëve për armëpushim me Hezbollahun, duke thënë se bombardimet do të vazhdojnë.

Një sulm izraelit të premten i vrau nëntë anëtarë të një familjeje, përfshirë katër fëmijë, në qytezën kufitare të Libanit, Sheba, tha për Reuters Mohammad Saab,

kryetar i qytezës.

Hezbollahu është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Bashkimi Evropian e ka vendosur në listën e zezë krahun e tij të armatosur, por jo edhe partinë e tij politike. Partia politike e Hezbollahut ka ulëse në Parlamentin libanez.

Mbi 600 njerëz janë vrarë në Liban nga e dita e hënë si pasojë e bombardimeve izraelite, thotë Ministria e Shëndetësisë e Libanit.

Hezbollahu tha të premten se hodhi raketë në drejtim të Izraelit, në qytetin Haifa, i cili ndodhet rreth 30 kilometra larg kufirit, si dhe në qytetin Tiberias, duke thënë se këto sulme ishin përgjigje ndaj sulmeve ajrore izraelite në fshatra, qytete dhe civilë.

Megjithëse kundërajorët izraelitë i kanë rrëzuar shumicën e raketave të Hezbollahut, duke e kufizuar dëmin e tyre, sulmet e grupit militant e kanë prishur

jetën normale përgjatë shumicës së kufirit verior të Izraelit.

Konflikti në mes të Izraelit dhe grupit të armatosur rëndë Hezbollah është më i ashpri mes tyre në 18 vjetët e fundit dhe ka ngjallur frikën se mund të shpërthejë një luftë e gjerë rajonale.

Shtetet e Bashkuara dhe Franca propozuan të mërkurën një armëpushim të menjëhershëm 21-ditor përgjatë kufirit Izrael - Liban dhe thanë se bisedimet janë duke vazhduar.

Netanyahu tha të premten se ekipet izraelite mbajtën takime për të biseduar për propozimet e ShBA-së për armëpushim të enjten dhe se do t'i vazhdonin ato edhe në ditët në vijim, duke shtuar se i vlerëson përpjekjet e ShBA-së. "Ekipet tona u takuan [më 26 shtator] për ta diskutuar iniciativën e ShBA-së dhe se si mund ta çojmë përpara qëllimin e përbashkët për kthimin e njerëzve në shtëpitë e tyre. Ne do



t'i vazhdojmë ato diskutime në ditët në vijim", tha ai në një deklaratë.

Të enjten, pasi Netanyahu u nis për në Nju-Jork, ku po merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, zyra e tij lëshoi një deklaratë duke thënë se kryeministri kishte urdhëruar trupat izraelite ta vazhdonin luftimin me forcë të plotë në

Liban.

Deklarata e tij nuk u referohej komenteve të ministrit të Jashtëm Katz, i cili të enjten hodhi poshtë propozimet për armëpushim, apo politikanëve të tjerë izraelitë që i kanë bërë jehonë atij qëndrimi, duke thënë vetëm se kishte pasur "shumë keqraportime rreth iniciativës së ShBA-së për armëpushim".

## Shigeru Ishiba pritet të emërohet kryeministër i ri i Japonisë

TOKIO, 27 SHTATOR - Ish-ministri i Mbrojtjes, Shigeru Ishiba, pritet të bëhet kryeministër i ri i Japonisë të premten, pasi e fitoi një garë të ngushtë për ta udhëhequr Partinë në pushtet Liberal Demokrate (LDP).

Ishiba, 67 vjeç, e mposhti kandidaten nacionaliste Sanae Takaichi në balotazh, në një garë e cila ishte ndër më të paparashikueshmet për liderin e partisë në dekadat e fundit. Plot nëntë kandidatë garuan për këtë post.

Lideri i LDP-së, partisë e cila e ka udhëhequr Japoninë pothuajse përgjatë gjithë epokës pas luftës, e ka praktikisht të sigurt emërimin kryeministër i vendit për shkak se



partia e ka shumicën në Parlament.

Kryeministri në largim, Fumio Kishida, njoftoi në gusht se do të

japë dorëheqje për shkak të një varg skandalesh të cilat zbehën popullaritetin e partisë.

"Ne duhet t'i besojmë popullit,

duhet ta themi të vërtetën me guxim dhe sinqeritet, dhe të punojmë së bashku për ta bërë Japoninë vend të sigurt, ku të gjithë mund të jetojnë me buzëqeshje përsëri", tha Ishiba gjatë një fjalimi të shkurtër para ligjvënësve pas votimit.

Qasja e tij ndaj diplomacisë me aleatin më të madh të Japonisë, ShBA-në, do të jetë në qendër të vëmendjes, duke qenë se ai vazhdimisht ka kërkuar që marrëdhëniet mes tyre të jenë më të baraspeshuara.

Gjatë fushatës së tij ai bëri thirrje edhe për krijimin e një NATO-je aziatike, një ide e cila e ka zemëruar Kinën, dhe që është hedhur poshtë nga një zyrtar i lartë

amerikan.

Ambasadori amerikan në Japoni, Rahm Emanuel, e uroi Ishibën për postin dhe tha se mezi pret të punojë me të për forcimin e aleancës ShBA - Japoni.

Ishiba u fut në Parlament më 1986, pas një karriere të shkurtër në bankë, por qëndrimet e tij kanë bërë që ai të ketë armiq brenda LDP-së. Ai ishte lënë mënjanë nga kryeministri në largim Kishida, dhe u bë zë kundërshtar në parti, duke gëzuar përkrahje të madhe nga publiku dhe anëtarë të partisë. Ai e ka kundërshtuar përdorimin e rritur të energjisë bërthamore dhe e ka kritikuar partinë e vet për moslejimin e çifteve të martuara të përdorin mbiemra të ndarë.

## 'GAP'-i: Vetëm 42 për qind të premtimeve janë realizuar nga kryetarët e komunave

Instituti GAP ka publikuar të premten shkallën e përbushjes së premtimeve zgjedhore të dhëna nga kryetarët e komunave për mandatin 2021-2025. Ky përditësim përfshin periudhën deri në fund të qershorit 2024. Nga gjithsej 1 816 premtime të dhëna nga 27 kryetarë të komunave, 765 premtime apo 42 % janë përbushur plotësisht, ndërkaq 304 premtime apo 17 % konsiderohen gjysmë të përbushura

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Në platformën elektronike "Letërnjoftimi i komunave", të premten instituti GAP, me përkrahje të Helvetas/Projekti për Decentralizimin dhe Përkrahje Komunave (DEMOS), ka publikuar shkallën e përbushjes së premtimeve zgjedhore të dhëna nga kryetarët e komunave për mandatin 2021-2025.

Ky përditësim përfshin periudhën deri në fund të qershorit 2024. Nga gjithsej 1 816 premtime të dhëna nga 27 kryetarë të komunave, 765 premtime apo 42 % janë përbushur plotësisht, 304 premtime apo 17 % konsiderohen gjysmë të përbushura, 326 premtime apo 18 % janë të filluara, ndërsa 421 premtime apo 23 % ende nuk kanë filluar dhe nuk është ndërmarrë asnjë hap për përbushjen e tyre. Vlerësuar sipas fushave, përqindja

më e lartë e premtimeve është përbushur në fushën e administratës dhe atë të shëndetësisë me 66 %, pasuar nga fusha e arsimit, bujqësisë dhe ekonomisë me së paku 50 % të premtimeve të dhëna. Fushat me përbushjen më të ulët të premtimeve janë infrastruktura, urbanizimi dhe shërbimet publike.

Krahasuar me përditësimin e vitit të kaluar, ku përqindja e premtimeve të përbushura ishte 26 %, këtë vit kjo përqindje është rritur në 42 %. Te premtimet gjysmë të përbushura, përqindja është rritur nga 16 % në 17 %, ndërsa për premtimet e filluara përqindja ka rënë nga 23 % në 18 %. Për premtimet e pafilluara, ka pasur një rënie nga 35 % në 23 %.

Për dallim nga vitet e kaluara, kur përbushja e premtimeve ishte kryesisht e fokusuar në fushën e infrastrukturës, këtë vit vërehet më shumë në fushën e

administratës dhe shëndetësisë. Në fushën e administratës premtimet kanë përfshirë rritjen e transparencës në vendimmarrje, publikimin e akteve komunale, përfshirjen e grave në pozita udhëheqëse, respektimin e procedurave ligjore gjatë rekrutimeve për vendet e punës dhe thjeshtimin e procesit të dokumenteve zyrtare përmes digjitalizimit. Në fushën e shëndetësisë premtimet lidhen me rritjen e orarit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, modernizimin e pajisjeve, përmirësimin e cilësisë dhe përgjegjësisë gjatë ofrimit të shërbimeve, kontrollet specifike mjekësore për kategori të veçanta, si dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe shërbimeve në shëndetësinë primare.

Ndërsa numri më i ulët i premtimeve të përbushura është në fushën e urbanizimit dhe infrastrukturës. Nga gjithsej 41 premtime të dhëna nga 27 kryetarë

komunash në fushën e urbanizimit, deri më tani janë përbushur vetëm 11. Këto premtime përfshijnë hartimin e planeve rregulluese, planeve zhvillimore urbane, hartave zonale, si dhe përsheptimin e procesit të legalizimit dhe pranimeve teknike të objekteve në terren.

Instituti GAP bën monitorim periodik të realizimit të premtimeve në 27 nga 38 komuna të Kosovës, ngaqë disa nga kryetarët aktualë nuk kanë zhvilluar fushatë aktive zgjedhore. Kryetarët e komunave sikurse Mamusha dhe të dhjetë komunave të banuara me popullsi me shumicë serbe nuk kanë shpallur ndonjë program zgjedhor dhe nuk kanë dhënë premtime konkrete. Vlerësimi i premtimeve bëhet në mënyrë periodike edhe përmes bashkëpunimit me organizatat lokale. Ky është vlerësimi i tretë për këtë mandat qeverisës të nivelit lokal.



## Besnik Tahiri: Administrata shtetërore në bllokadë!

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, në një konferencë për medie mbajtur të premten, ka thënë se administrata shtetërore është në bllokadë. Ai ka thënë se vendimet që i marrin personat zyrtarë që janë me pozitë ushtrues detyre mund të kontestohen nga institucionet juridike dhe të konsiderohen antiligjore, sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë. "Çka duhet të dihet: Kohëzgjatjen e funksionit e kufizon ligji, rrjedhimisht nuk ekziston mundësia që me akt nënligjor, siç është vendimi për zgjatje mandati, përtej atij që është shprehimisht i përcaktuar në ligj. Andaj, të gjitha vendimet që nënshkruhen nga ushtruesit e detyrës të cilët janë në funksion mbi një vit, mund të



konsiderohen në kundërshtim me ligjin dhe mund të mos prodhojnë asnjë efekt juridik ndaj palëve. Unë nuk kam asgjë kundër emrave të përveçëm që i bartin këto funksione, por kjo praktikë e

shkatërron shërbimin civil duke partizuar e politizuar administratën shtetërore, duke e vënë në pikëpyetje ligjshmërinë e akteve që nënshkruhen nga këta ushtrues detyre", ka thënë Tahiri.

Tahiri ka treguar se çfarë thotë ligji: "Neni 35, Ushtruesja/i e/i detyrës 1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit

të lartë drejtues. 2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/ime i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtrues/i detyrës më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtëmuajor, ky afat mund të zgjasë më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, është i paligjshëm. Urgjentisht duhet interpretim nga ministria e linjës, pra MPB-ja, përndryshe shteti bie në bllokadë", ka thënë Tahiri.



## 'Ngecën' Ligji për Sinjalizimin e Korrupsionit, KDI-ja inkurajon qytetarët të kontribuojnë për të mirën e përgjithshme

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Ligji për Sinjalizimin e Korrupsionit në Kosovë ende nuk ka nisur t'i japë rezultatet e pritura, andaj kërkohet më shumë angazhim ndërinstitucional. Kështu u tha të premten në tryezën e diskutimit të organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës. Ky ligj është hartuar për ta fuqizuar raportimin e korrupsionit. Ligji nuk është përdorur shumë nga punonjësit për t'i raportuar keqpërdorimet të cilat ndodhin brenda institucioneve.

Drejtori ekzekutiv në Institutin Demokratik të Kosovës, Ismet Kryeziu, ka deklaruar se sinjalizimi është mjet i rëndësishëm për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit pasi i inkurajon qytetarët të

kontribuojnë për të mirën e përgjithshme publike. Ai ka thënë se zbatimi i këtyre detyrimeve nga ana e ndërmarrjeve publike qendrore është objekti kryesor i këtij hulumtimi. "Sinjalizimi ka filluar në periudhë të mëvonshme dhe ende jemi duke punuar në atë drejtim. Dhe në këtë tryezë jemi mbledhur për të diskutuar pse është sinjalizimi dhe pse ka filluar si proces që ka për qëllim evitimin dhe parandalimin e korrupsionit. Sinjalizimi është mjet i rëndësishëm për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit sepse i inkurajon qytetarët të kontribuojnë për të mirën e përgjithshme publike duke denoncuar keqpërdorimet që mund të ndodhin në institucionet publike e private, por edhe në shoqëri. Nëpërmjet sinjalizimit një individ ka mundësinë të raportojë apo zbulojë informata

lidhur me veprimet që ndodhin në vendin e tij të punës e të cilat cenojnë interesin publik", ka thënë Kryeziu.

Zëvendësministri i Drejtësisë, Vigan Qorrolli, në fjalën e tij, adresoi disa çështje që mund të sjellin zbatim më të mirë në praktikë të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve brenda sektorit publik duke përmendur kështu: qartësimin e kriterëve të sinjalizimit dhe definimin e çështjeve që përbëjnë interes publik si dhe ndërtimin e një kulture që nxit sinjalizimin dhe mbështet ata që guxojnë të flasin dhe raportojnë parregullsitë. "Ne duhet ta shohim këtë proces jo vetëm si një detyrim ligjor, por si një mundësi për të ndërtuar një sistem më të fortë dhe më të besueshëm për të gjithë qytetarët tanë", ka theksuar zëvendësministri Qorrolli.

Më tutje zëvendësministri Qorrolli tha se rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet edhe trajnimit të zyrtarëve përgjegjës për trajtimin e rasteve të sinjalizimit dhe ngritjes së vetëdijes mbi të drejtat e sinjalizuesve.

Në fund, Qorrolli ka folur për rëndësinë e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve duke thënë se është një nga instrumentet themelore në luftën kundër korrupsionit dhe për promovimin e transparencës në sektorin publik.

Albesa Humolli nga KDI-ja ka thënë se korrupsioni është i pranishëm, por numri i sinjalizimeve mbetet i vogël. Vetëm gjatë këtij viti nga janari deri tani janë bërë 24 raste të sinjalizimit. "Lufta ndaj korrupsionit duhet të jetë prioritet ndërkombëtar. Raporti i sotëm na ofron një pasqyrë të qartë mbi praktikën e sinjalizimit. Për dallim

nga raportet e mëhershme, në këtë raport trajtojmë raste të suksessit që janë bërë nga sinjalizuesit. Janë zhvilluar intervista nga zyrtarët e ndërmarrjeve publike qendrore. Synimi ynë është që kjo tryezë të shërbejë si forum se si ta fuqizojmë mekanizimin e sinjalizimit në ndërmarrjet publike. Sinjalizimi me të vërtetë po tregon efekt, pasi po ndihmon prokurorinë dhe vetë ndërmarrjet në luftimin e korrupsionit", ka thënë Humolli.

Zyrtari përgjegjës për sinjalizim në KEK, Labinot Sadiku, ka bërë me dije se ky hulumtim ka kontribuar në luftimin e korrupsionit dhe dukurive negative. Ai ka theksuar se KEK-u gjatë tri viteve ka pranuar 91 raste të sinjalizimit. Pjesë e tryezës ishin përfaqësues nga ndërmarrjet e tjera publike dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

## "Gallup": Kosova, ndër vendet më të sigurta në botë

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Një sondazh ndërkombëtar ka gjetur se Kosova është ndër vendet me shoqëritë më paqësore dhe më të sigurta në botë.

Indeksi Global i Ligjit dhe Rendit, i kompanisë anketuese amerikane "Gallup", mat perceptimet e njerëzve për sigurinë e tyre dhe besimin në policinë lokale, ndër të tjera.

Kosova është renditur në mesin e 14 vendeve ku njerëzit ndihen më së shumti të sigurt duke ecur vetëm në rrugë gjatë natës. Sipas raportit mbi sigurinë globale, Kosova është renditur e 12-ta në

mesin e 14 vendeve.

I pari është renditur Kuvajti, pastaj Singapori, Norvegjia, Arabia Saudite, Tashikistani, Sllovenia etj.

Në mesin e shteteve më të pasigurt për të ecur vetëm gjatë natës është Malawi, Kili, Ekuadori etj.

Sipas "Gallup"-it, në vitin 2023, 70% e të rriturve në mbarë botën thanë se ndihen të sigurt duke ecur vetëm natën aty ku jetojnë, gjë që është dukshëm më e lartë sesa ishte një dekadë më parë dhe në shumicën e pikave në trendin gati 20-vjeçar të

"Gallup"-it.

"Megjithatë, përparimi në këtë masë ka ngecur në vitet e fundit dhe pak më pak njerëz sot ndihen të sigurt se në vitin 2020, kur një rekord prej 72% ndihej i sigurt", thuhet tutje.

Sipas "Gallup"-it, në shumicën e vendeve dhe territoreve të zhvilluara ekonomikisht me sundim të fortë të ligjit, shumica e banorëve thanë se ndihen të sigurt duke ecur vetëm në zonat e tyre gjatë natës.

E njëjta gjë është e vërtetë në vendet ku popullsia është në kontroll më të rreptë shtetëror.



# Osmani në pritjen e presidentit amerikan: Aleancë që qëndron në themelet e shtetit tonë

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Presidentja Vjosa Osmani dhe Zotëria i Parë, Prindon Sadriu, kanë marrë pjesë në pritjen zyrtare të organizuar nga presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden dhe Zonja e Parë amerikane Jill Biden. "Aleancë që qëndron në themelet e shtetit tonë!", ka shkruar Osmani krahas fotografisë së përbashkët, duke falënderuar për mikpritjen dhe bashkëpunimin. Fotografi të përbashkët me çiftin presidencial ka publikuar edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili e ka quajtur atë "Fotoja e ditës". Osmani gjatë qëndrimit të saj në Nju-Jork është takuar edhe me

ndihmësekretarin amerikan të Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, me të cilin ka diskutuar për sigurinë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Osmani tha se gjatë takimit është diskutuar edhe për thellimin e bashkëpunimit me ShBA-në. "Takimi i radhës me ndihmësekretarin e Shtetit, Jim O'Brien, për të diskutuar për thellimin më tutje të bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara, si dhe ndërmarjen e hapave që janë në interes të qytetarëve të Kosovës, integritet euroatlantik të vendit tonë, si dhe paqes dhe sigurisë në të gjithë rajonin", ka shkruar ajo në

"Facebook". Osmani po qëndron në ShBA dhe po merr pjesë në disa ngjarje, teksa liderët botërorë janë mbledhur për punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, ka deklaruar se ShBA-ja është sfiduar nga kryeministri Albin Kurti dhe qeveria e tij në disa aspekte. Ai ka thënë se cilësia e partneritetit në mes të ShBA-së dhe Kosovës "nuk është ajo që do të shpresonim të ishte në disa nga këto çështje që lidhen me mënyrën se si ai trajton veriun dhe si ai e menaxhon dialogun".

ShBA-ja, po ashtu, i ka kërkuar Kosovës dhe Serbisë të marrin seriozisht dialogun për normalizimin e raporteve që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë të larta që nga viti i kaluar, kur një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator 2023. Kosova e fajëson Serbinë për këtë sulm, por Beogradi ka mohuar se ka gisht në të. Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë Millan Radoičiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në

Kosovë që gëzon mbështetjen e Serbisë. Së fundi, Kosova ka ngritur aktakuzë për sulmin e armatosur në Banjskë kundër 45 personave. Në aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale e Kosovës, Radoičiq cilësohet si "kreu i grupit terrorist". ShBA-ja dhe BE-ja kanë bërë thirrje që përgjegjësit të përballen me drejtësinë. Në paraburgim në Kosovë ndodhen vetëm tre persona që u arrestuan gjatë sulmit në Banjskë: Vladimir Toliq, Blagoje Spasojeviq dhe Dushan Maksimoviq. Shumica e të akuzuarve ndodhen në arrati.



## Bërnabiq: Presim qasje dhe masa ndryshe ndaj Kosovës pas zgjedhjeve në BE dhe ShBA

BEograd, 27 SHTATOR - Kryetarja e Kuvendit të Serbisë, Ana Bërnabiq, ka thënë se pret që, pas formimit të institucioneve të reja evropiane dhe pas zgjedhjeve presidenciale në ShBA në nëntor, qasja e Perëndimit ndaj Kosovës të ndryshojë dhe ajo të përballlet me "masa ndryshe". "Nëse arrijmë të ruajmë paqen, t'u bëjmë ballë të gjitha provokimeve, të cilat janë të tmerrshme, mund të presim, mendoj, masa krejtësisht të ndryshme dhe qasje tjetër ndaj Prishtinës", tha Bërnabiq për Radio Televizionin e Serbisë (RTS). Ajo ka vlerësuar se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, po "përdor qetësinë në punën e institucioneve evropiane" para se

të formohen institucionet e reja për të "shkaktuar konflikt të armatosur" në Kosovë. Zgjedhjet për Parlamentin Evropian (PE) u mbajtën në qershor dhe në fund të vjeshtës do të fillojë mandati pesëvjeçar i Komisionit të ri Evropian (KE). "PE-ja është formuar, KE-ja duhet të formohet, por as PE-ja nuk po punon me kapacitet të plotë. Kemi zgjedhje në ShBA në nëntor dhe ai po e shfrytëzon këtë", tha Bërnabiq për Kurtin, më sa duket duke iu referuar veprimeve të Qeverisë së Kosovës për mbylljen e institucioneve paralele serbe në veri të Kosovës muaj më parë dhe synimit të saj për ta hapur urën mbi lumin Ibër.

Bërnabiq shtoi se "aleatët më besnikë të Prishtinës" tani kanë një qëndrim më kritik ndaj Kosovës dhe Albin Kurtit se më parë, pasi Shtetet e Bashkuara dhe vende të BE-së i kanë kritikuar haptazi veprimet e Kurtit në veriun e banuar me shumicë serbe, duke i cilësuar të "njëanshme" dhe të "pakoordinuara". Beogradi i ka cilësuar "akte kriminale" që synojnë "persekutimin e serbëve" mbylljen e institucioneve paralele serbe në veriun e Kosovës. Autoritetet e Kosovës ngulin këmbë se ato janë të "jashtëligjshme" dhe shkelin rëndin kushtetues të vendit.



# Roli i diplomacisë së Shqipërisë në forumet ndërkombëtare dhe angazhimi për pranimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare



Shkruan:  
Prof. Dr. Fejzulla  
BERISHA

Kontributi i Shqipërisë në mbështetjen e Kosovës në arenën ndërkombëtare ka qenë vazhdimisht i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm, veçanërisht në periudhën pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe në respektim të instrumenteve të njohura, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Karta e Kombeve të Bashkuara, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë veprimesh diplomatike për sensibilizimin e komunitetit ndërkombëtar lidhur me situatën në Kosovë dhe të drejtat e popullit shqiptar. Gjatë krizës së shpërbërjes së Jugosllavisë dhe përshkallëzimit të konflikteve në Kosovë, diplomacia shqiptare ka pasur një rol të rëndësishëm në denoncimin e shkeljeve të rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut nga regjimi serb, në përputhje me obligimet ndërkombëtare të shteteve për respektimin e Konventave Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Këto përpjekje kanë qenë të kombinuara me angazhime të tjera që synonin ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës në organizma ndërkombëtarë. Gjatë luftës në Kosovë, Shqipëria u shfaq si një partner strategjik për sigurinë rajonale, duke ofruar mbështetje logjistike dhe humanitare në përputhje me normat e të drejtës ndërkombëtare humanitare. Kjo mbështetje përfshinte jo vetëm ndihmë për Ushtrinë Çlirimtare të

Kosovës (UÇK), por edhe sigurimin e mbrojtjes dhe kujdesit për qindra mijëra kosovarë të larguar me dhunë, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre shtesë. Roli i Shqipërisë ka qenë po ashtu i qenësishëm edhe në periudhën pas përfundimit të luftës, në proceset diplomatike që synonin njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare.

Në diplomaci, heshtja është një mjet kompleks që shpesh përdoret si pjesë e një strategjie të përllogaritur për të arritur objektiva afatgjata ose për të shmangur përshkallëzimin e situatave të ndjeshme. Shqipëria, si një vend i vogël, por i rëndësishëm në kontekstin e Ballkanit, dhe si një aleat i fuqishëm i Perëndimit, shpesh ndjek një qasje të kujdesshme në forume ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, veçanërisht kur përballet me çështje që përfshijnë tensione të ndjeshme, si marrëdhëniet me Serbinë dhe rolin e saj në rajon.

Shqipëria dhe diplomacia ndërkombëtare në OKB. Në forume ndërkombëtare, veçanërisht në Kombet e Bashkuara, ku pjesëmarrja diplomatike është thelbësore, Shqipëria ka një angazhim aktiv për të promovuar interesat e saj dhe të rajonit, përfshirë edhe mbrojtjen e Kosovës. Megjithatë, OKB-ja është një arenë komplekse ku vendet duhet të peshojnë me kujdes çdo reagim dhe të mbajnë një ekuilibër delikat mes qëndrimeve të tyre dhe aleancave ndërkombëtare. Në çështjet që lidhen me Kosovën dhe Serbinë, Shqipëria ka një interes të veçantë për shkak të lidhjeve të ngushta etnike, historike dhe politike me Kosovën. Sidoqoftë, diplomacia e drejtpërdrejtë ndaj Serbisë në skenën ndërkombëtare, veçanërisht në OKB, mund të jetë

e kufizuar për disa arsye:

- Forca e Aleancave të Mëdha: Shqipëria është një aleat i fortë i SHBA-së dhe Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, ajo mund të zgjedhë të veprojë në koordinim me këto fuqi për të mbështetur përpjekjet e Kosovës për njohje ndërkombëtare dhe për të kundërshtuar retorikën serbe, por pa bërë ndërhyrje të drejtpërdrejta të cilat mund të jenë kundërproduktive. SHBA-ja dhe BE-ja kanë peshë më të madhe në skenën ndërkombëtare, dhe Shqipëria mund të mbështetet tek ato për të kryer rolin kryesor në ballafaqimin me Serbinë dhe për të penguar diskreditimin e rolit përfundimor në Kosovë.

- Dialogu Kosovë-Serbi i ndërmjetësuar nga BE-ja: Në dekadat e fundit, dialogu mes Kosovës dhe Serbisë është udhëhequr dhe ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, me mbështetjen e fuqive përfundimtare, përfshirë SHBA-në. Shqipëria mund të ketë zgjedhur të mbështesë këtë dialog dhe të punojë me BE-në për të nxitur arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Një angazhim publik shumë i ashpër i Shqipërisë kundër Serbisë në forume ndërkombëtare mund të shkatërrojë përpjekjet diplomatike të bëra në kuadër të këtij dialogu.

- Politika rajonale e bashkëpunimit: Shqipëria ndjek një politikë të bashkëpunimit rajonal dhe mbështet integrimin e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Pavarësisht konflikteve historike dhe tensioneve të vazhdueshme, një përqendrim i marrëdhënive me Shqipërisë dhe Serbisë mund të dëmtojë jo vetëm pozicionin diplomatik të Shqipërisë, por edhe proceset e integritit rajonal që janë thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin politik të Ballkanit. Shqipëria ka një përgjegjësi të

veçantë dhe historike në mbështetjen e Kosovës, dhe aktivizimi i saj në forumet ndërkombëtare është thelbësor për të avancuar çështjen e Kosovës në organizmat globalë. Duke marrë parasysh lidhjet e thella historike, kulturore dhe politike midis dy vendeve, Shqipëria duhet të shfrytëzojë pozitën e saj ndërkombëtare për të promovuar pranimin e Kosovës në organizata si Kombet e Bashkuara (OKB), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), UNESCO, INTERPOL, dhe organizata të tjera rajonale e ndërkombëtare. Mënyrat kryesore ku Shqipëria mund të përforcojë rolin e saj janë:

- Diplomacia bilaterale dhe multilaterale: Shqipëria duhet të përdorë marrëdhëniet e saj me vendet e BE-së dhe NATO-s për të bindur më shumë shtete që të njohin Kosovën si shtet të pavarur dhe të mbështesin anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare. Duke qenë anëtare e NATO-s dhe kandidatë për në Bashkimin Evropian, Shqipëria ka akses të drejtpërdrejtë në këto institucione ku mund të promovojë fuqimisht interesat e Kosovës.

- Lobimi në OKB: Një nga sfidat më të mëdha për Kosovën mbetet anëtarësimi në OKB, pasi disa vende me veto, si Rusia dhe Kina, janë kundër njohjes së saj. Shqipëria mund të zhvillojë një diplomaci më agresive dhe të bashkërendojë përpjekjet me partnerët ndërkombëtarë për të ndikuar tek vendet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Kjo mund të përfshijë angazhimin e drejtpërdrejtë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, ku vendimet nuk varen nga vetoja e Këshillit të Sigurimit.

- Shfrytëzimi i pozitave në organizata ndërkombëtare: Shqipëria mund të forcojë angazhimin e saj në organizata si Këshilli i Evropës, OSBE dhe

organizata të tjera rajonale. Duke qenë një vend që përfaqëson Ballkanin në këto forume, ajo mund të marrë rol udhëheqës në promovimin e Kosovës dhe zbutjen e rezistencës nga vendet që ende hezitojnë ta njohin.

- Aktivizimi i diasporës shqiptare: Diaspora shqiptare, që është e pranishme në shumë vende me ndikim global, mund të luajë një rol të rëndësishëm në lobimin për njohjen e Kosovës dhe për pranimin e saj në organizatat ndërkombëtare. Shqipëria mund të koordinojë me diasporën në vende si SHBA, Gjermani, Zvicër, Mbretëria e Bashkuar dhe të tjera, për të bërë fushata lobimi të fuqishme që të bindin liderët politikë për të mbështetur Kosovën në këto çështje.

- Zhvillimi i një strategjie kombëtare dhe rajonale: Shqipëria duhet të bashkërendojë një strategji më të qartë dhe të unifikuar me Kosovën, për të lobuar së bashku në forume të ndryshme ndërkombëtare. Një strategji e tillë mund të përfshijë edhe mbështetjen për integrimin ekonomik të Kosovës në tregjet rajonale dhe në marrëveshje ndërkombëtare që i hapin rrugën anëtarësimit të saj në struktura globale.

Shqipëria, duke qenë një vend që aspirojnë anëtarësimin në BE, mund të përdorë këtë aspiratë për të forcuar mbështetjen evropiane për Kosovën, duke lobuar për të drejtat e qytetarëve të saj dhe për përfshirjen e saj në proceset integruese. Shqipëria, si një partner i rëndësishëm për Kosovën në rajon, ka potencialin për të ndihmuar në përfundimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Përpjekjet më aktive në diplomacinë ndërkombëtare dhe në forumet globale do të ishin jo vetëm një hap përpara për Kosovën, por edhe për stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor.

## Konstituohet menaxhmenti i ri i UP-së

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Në mbledhjen e Këshillit Drejtues të UP-së të premten, rektori në ardhje, prof. Arben Hajrullahu, ka paraqitur ekipin e tij me të cilin do të punojë deri më 15 shtator 2028.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues, Altin Sahiti, ka shkruar në "Facebook" se me statutin e ri, prorektorit emërohen nga rektori dhe më nuk do të hidhen në votim për t'i emëruar Këshilli Drejtues. Kjo, sipas tij, më parë ishte pjesë e 'ngërçit' ose e pazareve që bëheshin para funksionalizimit të

menaxhmentit të lartë, me statut të ri nuk do të ndodhë as për prorektor, madje as për prodekan. Prof. asis. dr. Albana Berisha Qehaja është zgjedhur prorektore për buxhet, financa dhe bashkëpunim me sektorin publik dhe atë privat. Prof. asoc. dr. Avni Hajdari është zgjedhur prorektor për kërkime shkencore, projekte dhe inovacion. Prof. asoc. dr. Naim Jerliu është zgjedhur prorektor për mësimdhënie, çështje të personelit akademik dhe botime. Prof. asis. dr. Rozafa Basha është zgjedhur prorektore për ndërkombëtarizim dhe shkëmbim akademik. Gjithashtu, ushtrues detyre i sekretarit të përgjithshëm të UP-

së është zgjedhur Besnik Loxha. "Një profil tjetër për Akreditim, Cilësi të Mësimin dhe Çështje të Studentëve do të bëhet me dije në ditët në vijim, që gjithsesi do të jetë profesore, pasi Statuti i ri obligon që të respektohet kuota gjinore. Kështu, në kryesimin e Këshillit Drejtues jam i lumtur që dy menaxhmentet e fundit kanë respektuar kuotën gjinore dhe kemi tre profesorë dhe tri profesore në menaxhmentin e lartë. I uroj shumë suksese menaxhmentit të ri! Uroj që standardi që është arritur në dy vitet e fundit me menaxhmentin e rektorit Qerimi, të ruhet dhe të kalojë në një nivel tjetër", ka shkruar Sahiti.



## Grenelli thotë se e ardhmja e Serbisë është pranë ShBA-së, dhe jo Kinës dhe Ruisë

PRISHTINË, 27 SHTATOR - I dërguari amerikan për dialogun në mes të Beogradit dhe Prishtinës gjatë administratës së ish-presidentit Donald Trump, Richard Grenell, ka thënë se e ardhmja e Serbisë është pranë Shteteve të Bashkuara, dhe jo pranë Kinës dhe Ruisë, raporton Zëri i Amerikës. Ai beson se në mes të ShBA-së dhe Serbisë ekziston një miqësi e sinqertë pavarësisht se kush është në pushtet. "Unë flas rregullisht me presidentin e (Serbisë, Aleksandar) Vuçiq dhe i them se duhet të shkëputet nga Rusia dhe Kina dhe të afrohet me Perëndimin dhe ShBA-në. Si një amerikan, shpesh jap këshilla të tilla dhe nuk hezitoj t'i promovoj vlerat e Perëndimit", tha Grenelli. Grenelli ishte ndër të ftuarit në pritjen "Serbia përtej së ardhmes", të cilën Misioni i Përhershëm i Serbisë në OKB e organizoi në Nju-Jork. Ish-zyrtari i administratës së Trumpit ka mbetur i afërt me përfaqësuesit e pushtetit në Serbi edhe pas largimit nga detyra. Presidenti i Serbisë i dorëzoi atij një dekoratë shtetërore në tetor të vitit 2023 dhe me atë rast vlerësoi

se roli i Grenellit në dialogun në mes të Beogradit dhe Prishtinës "jo vetëm që ka kontribuar për paqen dhe stabilitetin rajonal, por ka luajtur edhe një rol kyç në forcimin e lidhjeve në mes të ShBA-së dhe Serbisë". Në pyetjen e gazetarëve për gjendjen e tanishme në Kosovë, ish-zyrtari, i cili është ende aktiv në fushatën e Donald Trumpit, kritikoi administratën e presidentit të tanishëm amerikan Joe Biden. "Jam shumë i zhgënjyer që gjithë puna e mirë që ka bërë presidenti Trump në rajon është hedhur poshtë", tha ai. Sipas raportimit të "Zërit të Amerikës", për shkak të ndërhyrjes nga shërbimi për shtyp i presidentit të Serbisë, Grenell nuk iu përgjigj pyetjes së këtij mediumi për investimin e dhëndrit të Trumpit, Jared Kushner, në ndërtesën e ish-Shtabit të Përgjithshëm në Beograd. Serbia ka nënshkruar një kontratë me firmën e Kushnerit për "rivalizimin" e kompleksit të Shtabit të Përgjithshëm në qendër të Beogradit, i cili u



shkatërrua pjesërisht gjatë bombardimeve të NATO-s në vitin 1999. Ish-zyrtari i administratës Trump shpesh ka folur publikisht me lëvdata për projektin e dhëndrit të Trump në Beograd.

Grenell, ndër të tjera, vlerësoi se ndërtesa e ish-Shtabit të Përgjithshëm në Beograd, e cila është simbol i konfliktit, mund të shndërrohet në një urë miqësie në mes të Serbisë dhe ShBA-së. Në vendin e rrënojave nga

bombardimet është planifikuar ndërtimi i dy ndërtesave të larta me apartamente dhe hotele, megjithëse nga ky objekt, i ndërtuar mes viteve 1955 dhe 1965, nuk është hequr statusi i mbrojtjes së pasurisë kulturore.

## Rritje e ndjeshme e rasteve me kancer

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e Shëndetësisë për vitin 2023. Ky publikim ofron të dhëna për shëndetësinë dhe numrin e përgjithshëm të të punësuarve në institucionet publike dhe private, sëmundjet si dhe aktivitetet e tjera shëndetësore në Republikën e Kosovës. Sipas rezultateve të dalta nga ky publikim, nëse shikohet në përgjithësi niveli i vizitave në institucionet shëndetësore, e kryesisht atyre parandaluese, është rritur nëse shikojmë numrin e të gjitha vizitave në të gjitha nivelet e vizitave qofshin ato në shëndetin primar, sekondar apo edhe në atë terciar. Te të prekurit me kancer vërehet një rritje e ndjeshme nga viti 2022 ku kishte 3 110 raste të reja të prekura nga kanceri, derisa në vitin 2023 kemi 4 165 raste të reja. Ndërkaq numri i përgjithshëm i të punësuarve në shëndetësi në



sektorin publik në vitin 2023 ishte 13 894 të punësuar, prej tyre: 3 258 mjekë specialistë; 376 mjekë stomatologë; 77 farmacistë; 52 fizioterapistë; 7 714 infermierë; 174 bashkëpunëtorë shëndetësorë si dhe 2 243 staf jomjekësorë. Në bazë të odave të

profesionistëve shëndetësorë, në Kosovë gjatë vitit 2023 ka 26 636 punonjës shëndetësorë të licencuar dhe prej tyre kemi 5 287 mjekë, 16 134 infermierë, 2 448 stomatologë, 1 221 fizioterapeutë si dhe 1 546 farmacistë. Nga ky numër 15 097 janë femra,

ndërkaq 11 539 janë meshkuj. Numri i institucioneve private shëndetësore të licencuara ka arritur në 2 217, prej tyre 29 spitale si dhe 2 187 institucione të tjera shëndetësore si: ambulanca, poliklinika, laboratorë dhe kabinete.

Nga gjithsej 2 217 institucioneve private shëndetësore të licencuara, numrin më të madh e përbëjnë ambulancat stomatologjike me 439 prej tyre, pastaj vazhdon me 171 ambulanca gjinekologjike, 167 qendra diagnostike etj. Publikimi i Statistikave të Shëndetësisë 2023 ofron të dhëna për burimet njerëzore të të gjitha institucioneve shëndetësore në Republikën e Kosovës si dhe aktivitetet e vizitat në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), aktivitetet e Spitaleve të Përgjithshme, Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) si dhe shërbimet paraklinike, të sëmurët me TBC, sëmundjet ngjitëse, të sëmurët me sëmundje malinje, të prekurit me Covid-19, si dhe disa nga të dhënat e institucioneve private të licencuara, sigurimet shëndetësore, të lënduarit dhe të vdekurit në vendin e punës, Shërbimet nga Qendrat Profesionale të Shëndetit Mendor dhe vizita stomatologjike.

## IKShPK-ja: Vaksina kundër HPV tani e tutje ofrohet edhe për vajzat nga 13 deri në 21 vjeç

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se me rekomandim të Komitetit Profesional Këshillues për Vaksinim dhe me miratimin e Ministrisë së Shëndetësisë, tash e tutje ofrohet vaksinimi kundër Human Papilloma Virusit

(HPV) edhe për vajzat nga mosha 13-21 vjeçe. Për këtë grupmoshë vaksinimi kundër HPV bëhet në baza vullnetare. Vaksinimi bëhet në të gjitha Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare në komunat përkatëse dhe në IKShPK. Ndërkohë, pas fazës së parë

të suksesshme të vaksinimit kundër HPV, për vajzat e klasave të gjashta (12 vjeçe), sipas Kalendarit të rregullt të vaksinimit, tani ka filluar faza e dytë, gjatë të cilës, deri më 31 dhjetor 2024, vaksinën kundër HPV mund ta marrin edhe vajzat të cilat për arsye të ndryshme, nuk janë vaksinuar gjatë fazës së parë.



# Me “dyfish më shtrenjtë”, Kosova trumbeton inflacionin të ulët



## Çfarë thonë ekspertët?

Profesori i Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Mejd Bektashi, thotë se është paradoksale që inflacioni në Kosovë - vend që përdor euron - të jetë më i ulët se në vendet e Eurozonës. “Besoj se mund të ketë ndonjë gabim në përlogaritje ose ndonjë vonesë të përlogaritjes së shportës, çmimeve të produkteve...”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Ai kujton se inflacioni ka rënë krahasuar me kulmin e vitit 2022, por thotë se një gjë e tillë është rezultat i rënies së çmimeve në tregjet botërore. “Ky inflacion i ulët nuk është rezultat i politikave ekonomike të qeverisë aktuale, por është rezultat i stabilizimit të çmimeve në bursat botërore. Inflacioni është i importuar”, sipas Bektashit.

Rënia e inflacionit nuk do të thotë edhe rënie e çmimeve, por nënkupton se çmimet rriten më ngadalë. Vetëm herë pas here ato mund të bien pak në krahasim me muajin paraprak. “Në shumicën e tregjeve, përfshirë edhe Kosovën, nuk kemi rikthimin e çmimeve të vjetra, ndonëse ato çmime janë ulur në bursa. Merreni çmimin e vajit, të bukës, të shumë produkteve esenciale... të cilat faktikisht kanë mbetur nga periudha kur inflacioni ka qenë dyshifror”, thotë Bektashi.

Kosova importon gati të gjitha produktet nga vendet e rajonit, të BE-së dhe më larg.

Mesatarisht në vit ajo importon mallra në vlerë prej 5 miliardë eurosh - duke filluar nga produktet bazë deri tek ato ndërtimore - ndërsa eksporton nën vlerën e 1 miliard eurove - më së shumti produkte të metalit dhe plastikës.

Sipas të dhënave të ASK-së, importi i mallrave në gusht kishte vlerën e 582 milionë eurove, ndërsa eksporti 83.5 milionë euro. “Dhe, përderisa norma e inflacionit mbetet ende e lartë edhe në vendet nga të cilat importon Kosova, atëherë mund të themi se në fund të këtij viti do të kemi një inflacion prej rreth 3%”, thotë ish-guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, për Radion Evropa e Lirë.

**PRISHTINË, 27 SHTATOR** - “Ngritje pa kontroll e çmimeve”, “Çmimi i bukës në rritje”, “Çmimet e patundshmërive shkojnë në qiell”... Këta dhe tituj të ngjashëm mund të lexoheshin shpesh në ballinat e medieve në Kosovë, sidomos nga fillimi i vitit 2022 e kënde.

Atëkohë Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës dhe konflikti mes tyre - që të dyja eksportuese të mëdha të produkteve në botë - shkaktoi rritje të inflacionit - apo të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve - gjetiu.

Kosova, si vend importues i shumicës së produkteve, nuk mbeti e paprekur. Vitin 2022 e mbylli me normë mesatare të inflacionit rreth 12 për qind. Më 2023 dhe këtë vit inflacioni shkoi duke rënë në numra njëshifrorë, por jo edhe çmimet e shërbimeve dhe të produkteve të konsumit.

Të mërkurën e 25 shtatorit REL-i publikoi një tabelë krahasuese të inflacionit në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së e Eurozonës.

Shifrat e siguruar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës e nxorën vendin me inflacionin më të ulët

në gusht - 1.4 për qind - që është më pak se edhe mesatarja e BE-së, edhe e Eurozonës.

Për krahasim, inflacioni në gushtin e vitit 2023 ishte 3.2 për qind.

Autoritetet e Kosovës i trumbetuan shifrat si sukses të tyrin.

Ministri i Financave, Hekuran Murati, listoi në “Facebook” një sërë masash që tha se i ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës, në mënyrë që ndikimi i rritjes së çmimeve në nivel global të ishte sa më i përbalueshëm. “Nuk ka asnjë qeveri në rajon që ka ndërmarrë kaq shumë masa për mbështetjen e qytetarëve e bizneseve për ta përballuar inflacionin. Këtë e konfirmojnë edhe të dhënat zyrtare të Eurostat-it dhe të agjencive përkatëse të statistikave”, shkroi Murati në “Facebook”.

Shifrat për Kosovën i shpërnda edhe ministria e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, por ajo ia atribuoi ato Eurostat-it - agjencisë së statistikave të BE-së - dhe jo ASK-së. Kjo nxiti reagimin e disa kritikëve në rrjetet sociale. “Ministria abuzon me një institucion të BE-së”,

shkroi në Facebook Shenoll Muharremi, njohës i integritimeve evropiane.

Ish-ministria e Financave, Hykmete Bajrami, tani deputete e Lidhjes Demokratike të Kosovës në opozitë, shpreh mosbesim ndaj shifrës 1.4 % të inflacionit. “Qytetarët jetojnë më keq, sepse çdo gjë kushton më shumë, ndërsa pagat kanë mbetur njëjtë”, thotë ajo për Radion Evropa e Lirë. “Prej vitit 2021 deri më sot çmimi i miellit është rritur për 52 për qind, çmimi i bukës për 48 %, çmimi i qumështit për 37 %...”, shton Bajrami.

## “Çmime dyfish”

REL-i kërkoi komente edhe nga disa qytetarë në Prishtinë për çmimet në treg.

Për Nysret Ahmetin inflacioni është shumë më i lartë se shifra e ASK-së prej 1.4 %. “Këtë e shohim në furnizimet e përditshme, në ushqime, në veshmbathje... Nëse i krahasojmë ushqimet, për shembull - tash është sezoni kur ne kemi qejf të konservojmë turshi - [çmimet] janë dyfish më

të larta se vitin e kaluar”, thotë juristi në pension. “Jam duke shpenzuar dyfish më shumë në disa produkte të caktuara, krahasuar me shumën që kam shpenzuar para një viti”, thotë Rita Mulaj, punonjëse në marketing. “Merr qumësht, varësisht prej llojit, ke ngritje goxha të madhe të çmimit. Ujin kur duhet ta blesh, apo të gjitha produktet që nuk bën pa to... ato të higjienës... e vërej që kanë ngritje të madhe [çmimesh]”, shton ajo.

Edhe Albatrit Matoshi, i cili punon në njërin prej institucioneve të Kosovës, thotë se produktet ushqimore janë shumë më shtrenjtë krahasuar me vitin e kaluar. “Mund të them se çfarë kemi blerë më herët me 200 euro - harxhin mujor - sot nuk mund ta marrësh ndoshta as me 300 euro. Jeta jonë është shtrenjtuar dhe nëse nuk dimë ta menaxhojmë paranë, e kemi problem ta lidhim muajin me muaj”, thotë Matoshi. Paga mesatare në Kosovë është rreth 520 euro, ndërsa minimalja nga 1 tetori pritet të jetë 350 euro. E pandryshuar nga viti 2011, vlera e minimalës aktualisht është 130-170 euro.

## Kosova përmbyll me sukses marrëveshjen e tregtisë së lirë me vendet e EFTA-s

**PRISHTINË, 27 SHTATOR** - Kosova ka përmbyllur me sukses negociatat për Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me vendet e Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA): Islandën, Lihtenshtajnin, Norvegjinë dhe Zvicrën. “Pas katër raundeve negociata, të filluara në vitin 2022 kjo është një arritje e jashtëzakonshme për vendin, duke hapur kështu rrugën për zhvillim ekonomik dhe mundësi të reja për ndërmarrjet,

industritë dhe qytetarët nga të dyja palët. Marrëveshja përfshin fushën e tregtisë së mallrave dhe atë të shërbimeve. Vlen të theksohet që Kosova është i vetmi shtet nga vendet e rajonit, që negocion tregtinë e shërbimeve me vendet e EFTA-së. Kjo ka rëndësi jetike duke pasur parasysh potencialin që Republika e Kosovës ka në ofrimin e shërbimeve profesionale. Marrëveshja e sotme shënon

jo vetëm përfundimin e negociatave, por edhe fillimin e një partneriteti më të fortë mes vendeve tona. Dhe siç dihet, vendet e EFTA-së kanë rëndësi strategjike për ekonominë e vendit”, ka njoftuar Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Negotiatat e EFTA-s u udhëhoqën nga Zef Dedaj, udhëheqës i delegacionit të Kosovës, ndërsa nga radhët e EFTA-s nga Karin Buechel,









**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Derbi në Pejë

**PEJË, 27 SHTATOR** - Për shkak të paraqitjes në Kupën Evropiane, Kastrioti i Ferizajt nuk i ka luajtur ende ndeshjet e dy xhirove të para në Superligën e Kosovës në hendboll. Ndeshjen e parë të edicionit 2024/2025 ferizajasit e luajnë të dielën. Dhe do të jetë derbi i vërtetë. Besa Famgas e

Kastrioti takohen nga ora 19:00 në palestrën "Karagaçi" në kryendeshjen e xhiros së tretë të hendbollistëve. Ndeshja pritet të jetë interesante dhe e hapur deri në fund. Besa në xhiron e parë e humbi ndeshjen interesante me Rahovecin, ndërsa në xhiron e dytë e mposhti Prishtinën. Besa

Famgas, ashtu si Kastrioti, kanë pretendime të mëdha këtë edicion. Kastrioti luajti me Sllobodën e Tuzllës në kuadër të raundit të parë të EHF European Cup. Në Ferizaj fitoi, ndërsa në Tuzëll të Bosnjë-Hercegovinës luajti ndeshje të fortë, por humbi dhe u eliminua. Të dielën është

edhe ndeshja në mes të Llapit e Trepçës, që fillon në ora 17:00. Të shtunën janë ndeshjet Vjosa - Vushtrria (19:00) dhe Rahoveci - Prishtina (19:00). Rahoveci ka fituar dy ndeshjet e para dhe synon pikë të reja ndaj Prishtinës. Prishtinasit, megjithatë, udhëtojnë për ta



dhënë maksimumin me synim për ta ndalur hovin e "vreshtarëve".

# Llapi e njofton me humbje Suharekën, sot zhvillohen dy ndeshje

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 27 SHTATOR** - Skuadra e Llapit e ka njoftuar me humbje Suharekën, pasi e ka mposhtur të premten me rezultat 3-0. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" i ka takuar javës së shtatë në elitën e futbollit të Kosovës.

Golin e parë për vendasit e ka shënuar nga penalltia Blend Baftiu në minutën e 27. Pjesa e parë përfundoi me rezultat 1-0. Në fillim të pjesës së dytë vendasit e realizuan edhe golin e dytë me anë të sulmuesit me përvojë të madhe Ahmed Januzi.

Mysafirët nga Suhareka u munduan të rikthehen në lojë, por ishte Llapi që në fund të ndeshjes realizoi edhe golin e tretë dhe të fundit në ndeshje (3-0). Autor i golit ishte Ramadani. Pas tri pikëve të reja, Llapi i Tahir Batatinës ngrihet në kuotën e 13 pikëve dhe momentalisht zë vendin e dytë, derisa Suhareka është e para me pikë të barabarta, por me një ndeshje me pak të zhvilluar.

Sot (e shtunë) zhvillohen dy ndeshje mjaft interesante. Në Klinë, Dukagjini, që nuk po arrin rezultate të pritshme, e pret skuadrën e Dritës, me synim që ta rikthejë në Gjilan duarthatë.



Në nën tjetër, mysafirët, që synojnë titullin, do të mundohen të nxjerrin më të mirën nga udhëtimi aspak i lehtë.

Kampioni në fuqi i elitës, Ballkani, e pret skuadrën e Ferizajt dhe pret tri pikët e plota, pas humbjes në ndeshjen e fundit nga Drita. Ferizaj do të

mundohet të befasojë Ballkanin, ani pse kjo punë nuk do të jetë e lehtë për faktin se në katër ndeshjet e fundit ka pësuar humbje dhe është në vendin e parafundit në tabelë.

Dy ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje zhvillohen të dielën. Në Drenas, Feronikeli 74 synon të marrë pikë në përballje me Malishevën që këtë edicion ka shkëlqyer sa iu përket rezultateve pozitive ndaj skuadrave favorite. Ndeshja tjetër është në mes të Gjilanit dhe Prishtinës. Vendasit kërkojnë këndelljen pas humbjes në ndeshjen e fundit, kurse kryeqytetasit synojnë edhe një fitore të ardhës për të konfirmuar

se janë në garë për titull. Prishtina prej pesë ndeshjeve të zhvilluara ka grumbulluar dhjetë pikë dhe renditet në vendin e tretë të Superligës.

### SUPERLIGA

Llapi - Suhareka 3-0

Të shtunën takohen:  
15:00 Dukagjini - Drita  
15:00 Ballkani - Ferizaj

Të dielën takohen:  
15:00 Feronikeli 74 - Malisheva  
15:00 Gjilani - Prishtina

## Sfida interesante në javën e tretë



**GJAKOVË, 27 SHTATOR** - Java e tretë në ProCredit Superligën e Kosovës në basketboll do të dhurojë sfida interesante. Përballja e parë e xhiros do të jetë ndërmjet Vëllaznimit dhe Trepçës. Kuqezinjët kanë një fitore dhe një humbje, derisa kampionët e nisën edicionin me fitoren ndaj Golden Eagle Yllit. Të

dielën është derbi i kësaj xhiro ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Sigal Prishtinës, ku të dy skuadrat numërojnë nga një fitore e një humbje. Derbi i skuadrave prizrenase po ashtu është interesant në mes të Proton Cable Prizrenit dhe Bashkimit, ku të dy skuadrat kanë nga një fitore. Kjo sfidë sjell

edhe sfidën në mes të vëllezërve Burim dhe Samir Zekiqi. Xhironja e tretë do të mbyllet me takimin në mes të Borës dhe Pejës, që duan fitoren e parë në këtë kampionat. Skuadra prishtinase debutoi në Superligë dhe ka dy humbje, kurse verdhezinjtë në ndeshjen e parë pësuan nga Vëllaznimi.

### PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 3

Të shtunën takohen:  
17:15 Vëllaznimi - Trepça

Të dielën takohen:  
17:00 Golden Eagle Ylli - Sigal Prishtina  
19:00 Proton Cable Prizreni - Bashkimi

Të martën takohen:  
19:00 Bora - Peja

# 'Dardanët': Turpi do të jetojë përjetë dhe nuk do të falet

**PRISHTINË, 27 SHTATOR** - Tifogrupi i Kosovës, "Dardanët", ka dalë me një reagim të ashpër pasi Shqipëria pritet ta organizojë Kampionatin Evropian U21 së bashku me Serbinë. Në reagim thuhet se me organizimin e kësaj ngjarjeje turpi do të jetojë përjetë dhe nuk do të falet. "Dikush ka vendosur ta normalizojë bashkëpunimin me të ashtuquajturit serbë dhe të ashtuquajturën Serbi si kurgjë hijë

duke shkelur me dy këmbë mbi emocionet, gjakun dhe plagët e freskëta të shqiptarëve të kësaj treve dardane", thuhet në reagim. "Pak ditë pasi kujtuam si popull rënie në detyrë të heroit Afrim Bunjaku dhe hyrjen terroriste, barbare e kriminale të çetnikëve të furnizuar me municion armësh nga vendi fqinj hegjemonist, na vjen lajmi zyrtar se nga Tirana paskan vendosur të bashkëpunojnë me Serbinë për



bashkorganizim të Euro 2027 për grupmoshën U-21". "Bashkëpunojnë me federatën e

atyre që nuk e shqipton asnjë dënim kur çdo javë klubet serbe shfaqin banderola shoviniste me flamurin e Kosovës të mbuluar me ngjyra të Serbisë apo kur tifozët e klubeve të Beogradit bëhen nxitës e motivues për rikthim të ushtrisë serbe në Kosovë, gjë që më pas u përpoq të ndodhë me një grup terrorist derisa mori përgjigjen e burrave dhe grave heroike të Republikës, të cilët u treguan se pragun e shtëpisë e mbrojnë në

çdo pëllëmbë të tij. Shqiptarët e Kosovës nuk kanë nevojë për poshtërim moral dhe emocional, por për ndihmë dhe përkrahje. Ngjarja edhe do të organizohet, por turpi do të jetojë përjetë dhe nuk do të falet. Kosova nuk do ta falë. Jo në emrin tonë!", ka përfunduar reagimi i "Dardanëve". Reagim pati edhe nga "Tifozat Kuq e Zi". Në reagimin e tyre thuhet se ky organizim "nuk mund të quhet i Shqipërisë".

## Edhe një projekt i rëndësishëm në Rahovec, nis ndërtimi i terrenit sportiv në Hoçë të Vogël

**RAHOVEC, 27 SHTATOR** - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se kanë filluar punimet për ndërtimin e terrenit sportiv në Hoçë të Vogël. Ai ka thënë se fusha sportive do të jetë me standarde bashkëkohore për futboll, për

basketboll, për volejball dhe për hendboll, me dimensione 40x20m, ku përfshihen rrethojat, ndriçimi dhe goma nga tartani. "Kjo fushë sportive do të shfrytëzohet nga nxënësit e ShFMU "Heronjtë e Kosovës" dhe nga qytetarët e fshatrave

Hoçë e Vogël dhe Brestoc. Ky projekt i nevojshëm financohet tërësisht nga një pjesë e vogël e Grantit të Performancës dhe kushton 70,962.00 euro. Përkujtojmë faktin që komuna jonë, për shkak të performancës së lartë (e para), ka fituar një

grantin që kap vlerën 1 milion e 645 mijë euro, i cili është shpërndarë në 5 projekte të reja të rëndësishme dhe në interes të qytetarëve. Urime për nxënësit dhe për qytetarët e fshatrave Hoçë e Vogël dhe Brestoc!", ka theksuar Latifi.



## Ricciardo largohet përfundimisht nga Formula 1

**PERTH, 27 SHTATOR** - Piloti austriak Daniel Ricciardo do të largohet nga skuadra e Racing Bull. Lamtumira e 33-vjeçarit nga garat e Formula 1 ka efekt menjëhershëm dhe nuk do të jetë në pistë në garën e ardhshme në Amerikë. Në vend të tij do të

jetë piloti 22-vjeçar Liam Lawson nga Zelanda e Re. Skuadra e Racing Bull ka vendosur ta promovojë sërish pilotin rezervë. Ai do të garojë në 6 garat e mbetura, me shpresën që të rikonfirmohet për vitin 2025. Gara e fundit në Singapor, ku dhe

fitoi 1 pikë për xhiron më të shpejtë, ishte e fundit për Daniel Ricciardo, që ka arritur 8 fitore në Formula 1. Ai është një nga pilotët më të dashur të këtij sporti nga fansat dhe vetë kolegët e tij. Ricciardo ka marrë pjesë në 258 gara në karrierën e tij. Ricciardo u

kthye në F1 vitin e kaluar, në Hungari, me makinë AlphaTauri, i cili më vonë u bë RB këtë sezon. Ai shënoi pikë në pesë raste dhe ishte i 14-ti në renditjen e pilotëve, 10 pikë prapa shokut të skuadrës Yuki Tsunoda. Paraqitjet e tij nuk ishin të mjaftueshme për



ta bindur familjen Red Bull për ta mbajtur atë.

## Kërkohet aktivitet më i madh fizik në shkollat e Kosovës

**PRISHTINË, 27 SHTATOR** - Komiteti Olimpik i Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport kanë organizuar "Forum in e Sportit", i cili mbahet në kuadër të aktivitetëve që po zhvillohen për "Javën Evropiane të Sportit". Në këtë forum u diskutua për nevojën e përfshirjes së të rinjve në sa më shumë aktivitete sportive, por edhe për nevojë e barazisë gjinore në sport.

Dekani i Fakultetit të Edukimit dhe Sportit, Musa Selimi, në panelin diskutues tha se në Kosovë ka nevojë për rritje të numrit të orëve të Edukatës Fizike në shkolla fillore. "Ne si fakultet kemi marrë masa dhe kemi kërkuar nga aktorë të rëndësishëm të shoqërisë civile nga Komisioni Parlamentar për Arsim. Kemi kërkuar takim urgjent që ta diskutojmë bashkërisht sepse, përveç fakultetit dhe universitetit, barrë të madhe ka edhe Ministria e Arsimit. Kemi kërkuar që të rritet urgjentisht fondi i orëve sepse situatën e kemi kritike, obeziteti, mungesa e aktivitetit fizik, mungesa e orëve të Edukatës Fizike, mungesa e infrastrukturës, të gjitha këto janë komponentë që ndikojnë në shëndetin e fëmijëve tanë. Organizata Botërore e Shëndetësisë jep që çdo ditë, çdo fëmijë të ketë 60 minuta minimumi aktivitet fizik", ka thënë Selimi.

Koordinatori i "Javës Evropiane për



Sport", Ibër Halaj, në panelin diskutues tha se për implementimin e një programi të tillë nevojitet koordinim më i madh ndërmjet organizatave sportive si dhe drejtorive sportive nëpër komunat e Kosovës. "Çdo program lidhet edhe me buxhetim dhe në këtë pjesë ende nuk kemi arritur që të kemi një plan strategjik i cili është në aspektin kombëtar. Andaj edhe plani strategjik mund të jetë në korniza të trasha, por duhet bërë një plan strategjik 'Grassroots' i cili është sektorial, por që koordinohet me pjesën e organizatave që lidhen me komunat përkatëse dhe drejtoritë për sport që janë nëpër komuna për t'i zhvilluar programet e veçanta", theksoi Alaj.

Gjithashtu, në panel u diskutua edhe për barazinë gjinore në organizatat

sportive ku u kërkuar përfshirje më e madhe e grave në pozitat administrative në federatat sportive të Kosovës. Afërdita Fazlija nga Ministria e Sportit theksoi se është e nevojshme që sporti i femrave të bëhet edhe profesion dhe jo vetëm pasion. "Sporti i femrave duhet të bëhet profesion, jo vetëm pasion, e që sporti i femrave të bëhet profesion, të paktën për këtë kohë, kam evidentuar se ndoshta pjesa e anës shkencore, konkretisht Fakulteti i Edukatës Fizike dhe disa institucione që në momente të caktuara ne iu drejtohemi si OJQ ose si programe të thjeshta siç është rasti i programi 'BeActive' t'ju them të drejtën... më tepër ky program jep produkte konkrete në fushën e sportit kur u jepet mundësia që të jenë pjesëmarrës fëmijët, prindërit, arsimtarët", ka thënë Fazlija.

### SHKURT

#### Bajrami në formacionin e xhiros së parë në Ligën e Evropës

Nedim Bajrami ka qenë fantastik në fitoren e Rangers 0-2 në udhëtim te Malmo. Mesfushori shqiptar ishte vendimtar në fitoren e skuadrës skoceze në udhëtim te Malmo, duke shënuar gol vetëm pas disa sekondave. E falë paraqitjes fantastike në kryeqytetin suedez, Bajrami ka zënë vend edhe në formacionin më të mirë të xhiros së parë në Ligën e Evropës. Në portë është portieri italian i Spursit, Vicario, që pati një mbrëmje të shkëlqyeshme. Mbrojtja përbëhet nga Paredes (Bilbao), Caleta-Car (Lyon) dhe Jemelka i Viktoria Plzenit. Ndërkohë në mesfushë, përveç Nedim Bajramit, janë edhe Olaru (Steaua), Verschaeren (Anderlecht) dhe Rasmus Kristensen i Eintracht Frankfurt. Treshja e sulmit janë Hugo Ekitike (Frankfurt), Dia i Lazios dhe Hauge i Bodo/Glimt.

#### KB Peja nuk arrin të kualifikohet në grupet e FIBA Europe Cup

KB Peja ka pësuar humbje nga Maroussi i Greqisë edhe në ndeshjen e dytë kualifikuese. Pejanët pësuan me rezultat 81:106 (28:22, 25:28, 13:32, 15:24). Në ndeshjen e parë kishin pësuar humbje 98:75, duke mos arritur të kualifikohen në grupet e FIBA Europe Cup. Të dyja ndeshjet u zhvilluan në Greqi për shkak të problemeve teknike në palestrën në Pejë. Skuadra pejane ishte më e mirë në çerekun e parë, duke e fituar këtë pjesë 28:22. Verdhezinjtë në periudhën e dytë ngritën epërsinë në dhjetë pikë, 34:24, por basketbollistët e skuadrës greke u rikthyen, për t'i barazuar shifrat në 48:48, ndërkohë që pjesa e parë përfundoi 53:50. Por, perioda e tretë ishte fatale për pejanët, që përfundoi 13:32 për skuadrën greke, që triumfoi në fund 81:106. Shahada Wells ishte më i miri te Peja me 25 pikë. Ndërkohë, pjesë e grupeve për edicionin e ri do të jetë Trepça, ku të premtën mbrëma do të dihen përfundimisht grupet për edicionin 2024-25.

#### Nadal: Alcaraz dhe Sinner do të dominojnë për shumë vjet

Sezoni 2024 në tenis për meshkuj ka pasur protagonistë dy tenistë: spanjollin Carlos Alcaraz dhe italianin Jannik Sinner. Të dy kanë fituar nga dy grand slam, duke zbritur përfundimisht nga fronti edhe Novak Djokoviqin, i fundit që mbijetoi nga epoka e dikurshme. Për tenistin spanjoll Rafael Nadal kjo dyshe do të dominojë gjatë skenën në këtë sport. "Sot për sot, Alcaraz dhe Sinner janë mbi të gjithë të tjerët. Nuk kam dyshim, madje Carlos do të bëhet një nga tenistët më të mirë në histori", u shpreh Rafael Nadal për mediet. Dy tenistët dominojnë edhe në renditjen botërore, me italianin që është "numri 1" dhe spanjollin që synon ta zbresë nga fronti. "Mendoj se Alcaraz është një hap më përpara se Sinner dhe mbetet favoriti kryesor për të fituar çdo turne ku merr pjesë", ka deklaruar Nadali.

## Messi dhe Ronaldo, me vlerën më të ulët në merkato

**MADRID, 27 SHTATOR** - Si në çdo gjë në jetë, çdo fillim e ka një fund. Nuk i shpëtojnë këtij "ligji të pashkruar" as yjet e futbollit. Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo dominuan skenat e këtij sporti për më shumë se dy dekada, por tani duhet t'i hapin rrugën një gjenerate të re, që gjithsesi do ta ketë shumë të vështirë t'i arrijë sukseset e tyre. Si "Pleshti" ashtu edhe "CR7" pranuan të bëjnë kompromis me këtë, duke u larguar nga futbollit i rëndësishëm, siç është ai evropian, me argjentinasi që zgjodhi Amerikën, ndërsa "luzitani", Arabinë Saudite, por kurba në zbritje e karrierës së tyre konfirmohet edhe nga "Transfermarkt". Sipas



specialistëve, Lionel Messi ka kapur pikën më të ulët sa i përket vlerës së tij në merkato që nga viti 2006. Tani që luan tek Inter Miami, kartoni i kampionit të botës vlerësohet 25 milionë euro. Akoma më "pikiatë" është zbritja e rivalit të tij të përjetshëm. Pavarësisht se kontrata

me Al-Nassrit është një nga më të pasurat në botë, kartoni i Cristiano Ronaldos në merkato vlerësohet vetëm 15 milionë euro. Tashmë vendin e tyre në listën e futbollistëve më të vlerësuar e kanë marrë yjet e rinj. Sipas "Transfermarkt", lista kryesohet nga Jude Bellingham, Erling Haaland dhe Kylian Mbappe. Të tre kanë një vlerë të njëjtë, 180 milionë euro, por për shkak të moshës, vendin e parë e mban "ylli" i Real Madridit, i ndjekur nga ai i Manchester Cityt dhe më pas nga ai i Paris Saint-Germainit, ndërsa "top 5" plotësohet nga Phil Foden i Manchester Cityt i vlerësuar në 150 milionë euro.

## Lewandowski: Yamal, anësori më i mirë në botë

Robert Lewandowski po shkëlqen në këtë edicion. Ai ka shënuar shtatë gola në po aq ndeshje. Vetëm Ayoze Perez me 6 gola dhe Raphinha dhe Kylian Mbappe me pesë gola mund të pretendojnë të jenë afër. Duke folur për mediet në

një intervistë të fundit, sulmuesi i Barcelonës thuri lëvdata të mëdha për fenomenin e ri të skuadrës Lamine Yamal dhe nuk u përmbajti duke e cilësuar një nga më të mirët. "Lamine Yamal është anësori më i

mirë në botë", ka thënë Lewa. "Një karrierë futbollit është kaq e gjatë, ndonjëherë nuk është e rëndësishme se si e filloni. Ajo që është më e rëndësishme është se si do të përfundoni apo si do të jenë vitet e ardhshme. Dhe në 15 vitet e

ardhshme ai do të jetë 32, dhe sigurisht që do jetë përsëri ndër më të mirët", ka thënë ai kur u pyet nëse Yamal mund të bëhet më i miri në botë. Me tre gola dhe pesë asistime tashmë në La Liga, 17-vjeçari ka qenë një nga lojtarët më

mbresëlënës të ligës deri më tani dhe është nominuar si lojtari i muajit për shtator. Pasi ka hapur llogarinë e tij edhe në Ligën e Kampionëve, Yamal duket i gatshëm për lartësi të mëdha këtë sezon.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

### NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURISIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 3 korrik 2024, për vendin e punës:

**I. Pozita:** Auditor junior për auditim të performancës

**Numri i referencës:** RAJAP/ZKA/05-06/24

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 1490 të datës 27.09.2024.

Prishtinë, 27.09.2024

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

*D. Shullhaj*

### OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU KONKURSA

Nacionalna kancelarija revizije obaveštava da se otkazuje konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a dana 03.07.2024. godine, za radno mesto:

**I. Položaj:** Junior Revizor za reviziju učinka

**Broj reference:** RAJAP/ZKA/05-06/24

Konkurs se otkazuje na osnovu odluke br. 1490 od datuma 27.09.2024.

Prishtina, 27.09.2024

Departman za upravljanje ljudskim resursima

*D. Shullhaj*

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Belkisa Selmani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Besart Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plot sh.f.m.u "Mazllom Këpuska" Gjakovë nga kl. 1-8.
- Faton Pruthi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Elizabeta Lekaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1. 2 të sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Elizabeta Lekaj nga Prishtina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 3.4 të sh.m.m. "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.
- Xhenete Fanda shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.
- Arijanit Kuqi nga Gajkova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m "Hysni Zajmi" Gjakovë, teknik Medicinal.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

